



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice
Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

ZSP- Nr. 165/24
Datë: 23/12/24

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 Mars 2019), si dhe dispozitat e nenit 65 të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21 / 18 shtator 2023) neni 11 i Rregullores Nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, Sekretarja e Përgjithshme nxjerr:

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm për interes të institucionit

1. Z. Muhamet Krasniqi, Zyrtar ligjor në Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në pozitën: Zyrtar i Lartë Ligjor për Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Civile në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Z. Muhamet Krasniqi, me datën 03.12.2024 ka parashtruar kërkesën me numër protokoli 05-2114 për transferimin të përhershëm në interes të institucionit nga pozita Zyrtar ligjor në Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Civile në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Andaj me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe interesave të institucionit për menaxhim sa më të mirë të punës së divizionit që transferohet u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi siç parashihet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ankesa i dërgohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Anita Kalanderi
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet;

- Z. Muhamet Krasniqi;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të MD-së.